



ЈАВНО ПРЕТПРИЈАТИЕ-СКОПЈЕ

**RAPORTE FINANCIARE ME SHËNIME SQARUESE
të NP “Parqe dhe gjelbërime” për vitin 2018**

Shkurt, viti 2019

HYRJE

Themelimi

Ndërmarrja publike “Parqe dhe gjelbërime” - Shkup ose emërtimi i shkurtër NP “Parqe dhe gjelbërime” përmes paraardhësve të saj ekziston prej vitit 1945, me emrin “Kopshte dhe parqe” dhe “Brezi i gjelbër”, që deri në vitin 1954 funksionon si “Drejtori për gjelbërim urban dhe jashtë urban”, deri më K.P. të komunës Idadija.

Më 01.03.1961, Këshilli popullor i komunës së Idadisë, ka themeluar Ndërmarrjen prodhuese komunale “Parqe dhe gjelbërime” të regjistruar me nr. 202/61 më 16.03.1961 në regjistrim pranë gjykatës ekonomike të rrethit të Shkupit.

Me aktvendim të Gjykatës ekonomike të rrethit të Shkupit me nr. 190/72, ndërmarrja komunale “Parqe dhe gjelbërime” është bashkuar me ndërmarrjen “Ujësjiellësi dhe kanalizimi” – Shkup, me këtë themelohet ndërmarrja e re shërbyese komunale “Komunalec” – Shkup.

Në suaza të NPK “Komunalec”, “Parqe dhe gjelbërime” funksionon si OOZT deri më 29.12.1992 kur me transformimin e NPK “Komunalec” është organizuar si ndërmarrje e posaçme publike “Mirëmbajtja e parqeve dhe gjelbërimeve” me numër të regjistrimit 19252/92 më 29.12.1992. Me aktvendimin nr. 809/93 është regjistruar ndryshimi i emrit të NP “Mirëmbajtja e parqeve dhe gjelbërimeve” GJ.TH.Shkup.

Me aktvendimin e gjykatës themelore Shkupi I Shkup, me numër të regjistrimit 3500/99 prej 15.10.2001 është realizuar harmonizimi me Ligjin për ndërmarrjet publike të ndërmarrjes publike “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup, me seli në rrugën “Ilindenska p.n. themelues i së cilës është Qyteti i Shkupit. NP ka veti të personit juridik dhe gjiro llogarinë e saj, kurse për obligimet e realizuara dhe të marra në qarkullimin juridik, përgjigjet me gjithë pronën e saj (përgjegjësi e plotë).

Veprimtaria

Ndërmarrja publike “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup, në fushëveprimin e saj të funksionimit i kryen këto aktivitete:

-81.30 veprimtari shërbyese për rregullim dhe mirëmbajtje të ambientit jetësorë.

-02.10 kultivim të pyjeve dhe veprimtari të tjera lidhur me pylltarinë.

Në funksion të veprimtarisë themelore, ndërmarrja kryen edhe veprimtari tjera:

- 01.30 – kultivimi i materialit për mbjellje
- 01.19 – kultivimi i të farave dhe të mbjellave tjera njëvjeçare

Organizimi

Ndërmarrja publike “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup, është person juridik dhe është bartës i të gjitha të drejtave dhe obligimeve në qarkullimin juridik dhe përgjigjet me gjithë pronën e saj (me përgjegjësi të plotë). Në qarkullimin juridik, prezantohet pavarësisht dhe posedon autorizime të pakufizuara.

Ndërmarrja publike “Parqe dhe gjelbërime” - Shkup është organizuar në 10 sektorë dhe 3 seksione, edhe atë:

1. Seksioni për marrëdhënie me opinionin
2. Seksioni për menaxhim me resurse njerëzore
3. Seksioni për punë të përgjithshme dhe juridike
4. Sektori për revidim të brendshëm
5. Sektori “Gjelbërimi urban”
6. Sektori “Gjelbërimi jashtë urban”
7. Sektori “Ngritja e gjelbërimit”
8. Sektori “Aletë e drunjve”
9. Sektori “Mekanizimi”
10. Sektori “Zhvillimi i qëndrueshëm”
11. Sektori për punë komerciale
12. Sektori për mbrojtje dhe kontrollim
13. Sektori për punë financiare

Ndërmarrjen e përfaqëson dhe prezanton drejtori i ndërmarrjes si përfaqësues ligjor.

Drejtori disponon me të gjithë autorizimet në qarkullimin juridik, në suaza të veprimtarisë së ndërmarrjes.

Numri i të punësuarve në NP “Parqe dhe gjelbërime” në fund të vitit 2018 arrin numrin 513, kurse në fund të vitit 2017 ishte 483.

Të punësuarit me angazhim të përkohshëm, përmes Agjencisë për punësime të përkohshme, përfundimisht me vitin 2018 arrin numrin 188, kurse në fund të vitit 2017 ka qenë 137.

Qarkullimi pagesor

Ndërmarrja publike, aktivitetet e nevojshme për realizim të qarkullimit pagesor i kryen në suaza të dispozitave të përcaktuara për këtë qëllim¹, gjatë kësaj ajo ka të hapura tre llogari në denarë, edhe atë në “Banka komerciale” SH.A, Shkup, në “Banka qendrore kooperative” SH.A. Shkup dhe në Shparkase banka SH.A. Shkup, si bartës të qarkullimit pagesor, përkatësisht me sa vijon:

	Gjiro llogaria	Deponent në
Llogaria në denarë	300000000114205	“Banka komerciale” SH.A, Shkup
Llogaria në denarë	20000000071204	Banka qendrore kooperative SH.A. Shkup
Llogaria në denarë	250101000409412	Shparkase banka SH.A. Shkup

Nënshkrues i autorizuar:

Përfaqësues ligjor i ndërmarrjes është Ardijan Muça u.d. drejtor² i ndërmarrjes.

Organi i udhëheqjes

Organi i udhëheqjes është përfaqësuesi ligjor i ndërmarrjes – drejtori, i cili në pajtim me dispozitat e nenit 23 të Ligjit për Ndërmarrjet publike (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 38/96.....64/18) emërohet nga Kryetari i Qytetit të Shkupit.

Organi i menaxhimit

Organi i menaxhimit të Ndërmarrjes publike “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup, është Këshilli drejtues i formuar me Vendimin për emërim të anëtarëve të Këshillit drejtues të Ndërmarrjes publike “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup, të regjistruar me numër 07-9866/4 të datës 27.12.2017, numër 27-1875/4 të datës 01.03.2018 dhe me numër 27-6470/3 të datës 18.07.2018 nga ana e Këshillit të Qytetit të Shkupit dhe i njëjti numëron 13 anëtarë.

Gjatë periudhës raportuese, Këshilli drejtues ka mbajtur 16seanca.

Kontrollimi i punës materialo - financiare

Kontrollimin e punës materialo – financiare të Ndërmarrjes publike “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup, e realizon këshilli mbikëqyrës për kontroll të punës materialo – financiare, i cili është i formuar me Vendimin për emërim të anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës për kontroll të punës materialo – financiare të Ndërmarrjes publike “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup, të regjistruar me numrin 07-9867/4 të datës 27.12.2017 dhe me numër 27-1876/4 të datës 01.03.2018, janëemëruar nga ana e Këshillit të Qytetit të Shkupit dhe i njëjti numëron 5 anëtarë.

Gjatë periudhës raportuese, Këshilli mbikëqyrës për kontroll të punës materialo – financiare ka mbajtur 5 seanca.

²Aktvendimi për zgjedhje të drejtorit me nr. 08-11052/1 i datës 07.12.2018

RAPORTI PËR FITIMET OSE HUMBJET (BILANCI I SUKSESIT)

për periudhën prej 01.01. deri më 31.12.2018

Nr. rend.	POZITA	AOP	Nr. i shënimit	2018	2017	Indeksi
1	I. TË ARDHURA NGA FUNKSIONIMI (202+203+206)	201		455.650.916.00	417.731.637.00	109
2	Të ardhura nga shitja	202	6.1	406.201.614.00	385.037.652.00	106
3	Të ardhura tjera	203	6.2	49.449.302.00	32.693.985.00	152
4	Ndryshimi i kth. të rezervave dhe prodhimeve dhe të prodhimit të papërfunduar	xxx				
4.a	Rezerva të prodhimeve dhe prodhimtarisë së papërfunduar	204				
4.b	Rezerva të prodhimeve dhe prodhim të papërfunduar	205				
5	Prodhimtaria e kapitalizuar pronësore dhe shërbime	206				
6	II. SHPENZIME NGA FUNKSIONIMI (208_213+218_222)	207		455.093.300.00	426.081.122.00	107
7	Shpenzime për lëndë të para dhe materiale tjera	208	6.3	90.003.626.00	77.176.830.00	117
8	Vlera furnizuese e mallrave të shitura	209				
9	Vlera furnizuese e materialeve të shitura, pjesë rezerve, inventarit të imët, ambalazhit dhe auto gomave	210				
10	Shërbime me karakter të shpenzimeve materiale	211	6.4	50.541.541.00	50.239.514.00	100
11	Shpenzime tjera nga funksionimi	212	6.5	6.379.118.00	6.475.751.00	99
12	Shpenzime për punonjësit (214+215+216+217)	213	6.6	225.753.515.00	198.051.974.00	114
12.a	Paga dhe kompensimet e pagave (neto)	214		150.529.885.00	132.075.229.00	114
12.b	Shpenzime për tatime dhe kompensime të pagave	215		11.114.224.00	9.836.188.00	113

12.c	Kontribute nga sigurimi i detyruar social	216		59.786.712.00	52.487.923.00	114
12.ç	Shpenzime tjera për punonjësit	217		4.322.694.00	3.652.634.00	118
13	Amortizimi i mjeteve materiale dhe jo materiale	218	6.7	11.530.793.00	8.287.303.00	140
14	Harmonizimi vlerësorë i mjeteve rrjedhëse	219	6.8		19.893.659.00	
15	Harmonizimi vlerësorë i mjeteve jo rrjedhëse	220	6.9	69.189.886.00	62.877.839.00	110
16	Rezervime për shpenzime dhe rreziqe	221				
17	Shpenzime tjera nga funksionimi	222	6.10	1.694.821.00	3.078.252.00	55
18	III. TË ARDHURA FINANCIARE (224+229+230_233)	223	6.11	18.359.00	66.997.00	28
19	Të ardh. financiare nga shoqëritë e konektuar (225 _ 228)	224				
19.a	Të ardhura nga investimi në shoqëritë e konektuar	225				
19.b	Të ardhura në bazë të kamatave nga puna me SHK	226				
19.c	Të ardhura tjera financiare nga puna me SHK	228				
20	Të ardhura nga investimet në shoqëritë e pa konektuar	229				
21	Të ardhura në bazë të kamatave nga puna me SHPK	230		18.359,00	66.997.00	28
22	Të ardhura në bazë të dallimeve të kurseve nga puna me SHPK	231				
23	Fitime të pa realizuara nga mjetet financiare	232				
24	Të ardhura tjera financiare nga puna me SHPK	233				
25	IV. SHPENZIME FINANCIARE (235+239_243)	234	6.12	196.048,00	422.226.00	47
26	Shpenzime financiare me shoq. e konektuar (236_238)	235				
26.a	Shpenzime në bazë të kamatave me SHK	236				
26.b	Shpenzime në bazë të dallimeve të kurseve me SHK	237				
26.c	Shpenzime tjera financiare nga puna me	238				

	SHK					
27	Shpenzime në bazë të kamatave me SHPK	239		172.587,00	414.737.00	42
28	Shpenzime në bazë të dallimeve të kurseve me SHPK	240				
29	Humbje të pa realizuara të mjeteve financiare	241				
30	Shpenzime tjera financiare nga puna me SHPK	242				
31	Shpenzime tjera financiare	243		23.461,00	7.489.00	314
32	Pjesëmarrja në humbjen e shoqërive të konektuar	244				
33	Pjesëmarrja në fitimin e shoqërive të konektuar	245				
34	Fitimi nga funksionimi i rregullt (201+223+244) - (204-205+207+234+234)	246	6.13	379.927.00		
35	Humbja nga funksionimi i rregullt (204-205+207+234+245) - (201+223+244)	247	6.13		-8.704.714.00	
36	Neto fitimi nga punët e ndërprera	248				
37	Neto humbja nga punët e ndërprera	249				
38	Humbja para tatimit (247+249) ose (247-248)	250		379.927.00		
39	Fitimi para tatimit (246+248) ose (246-249)	251			-8.704.714.00	
40	Tatimi i fitimit	252		5.406.643.00	4.891.074	111
41	Të ardhura të prolonguar tatimore	253				
42	Shpenzime të prolonguar tatimore	254				
43	NETO FITIMI PËR VITIN AFARIST(250-252+253-254)	255	6.14			
44	NETO HUMBJA PËR VITIN AFARIST (251+252-253+254)	256	6.14	-5.026.716,00	-13.595.788.00	37
45	Nr. mesatarë i punëtorëve në bazë të orëve punuese në periudhën e llogaritjes në shumë absolute	257		572	501	
46	Numri i muajve të punës në shumë absolute	258		12	12	
47	FITIMI / HUMBJA PËR PERIUDHËN	259		-5.026.716,00	-13.595.788.00	37

RAPORT PËR GJENDJEN FINANCIARE (BILANCI I GJENDJES)
më datë 31.12.2018

Nr. rend	POZITA	AOP	Nr. i shënimit	2018	2017	Indeksi
1	AKTIVI					
	A. MJETE JO RRJEDHËSE (002+009+020+021+031)	001		726.725.702.00	782.325.067.00	93
2	I. MJETE JO MATERIALE (003_008)	002	7.1	275.769.00	392.806.00	71
3	Shtesa për zhvillim	003				
4	Koncesione, patente, licenca, mbrojtje, shenja	004		275.769.00	392.806.00	71
5	Gudvill	005				
6	Avance për furnizim të mjeteve jo materiale	006				
7	Mjete jo materiale në përgatitje	007				
8	Mjete tjera jo materiale	008				
9	II. MJETE MATERIALE (010+013_019)	009	7.2	726.449.933.00	726.746.261.00	100
10	PATUNDSHMËRIA (011+012)	010		684.061.354.00	684.745.740.00	100
10.a	Truall	011		675.420.000.00	675.420.000.00	100
10.b	Objekte ndërtimore	012		8.641.354.00	9.325.740.00	93
11	instalime dhe pajisje	013		13.719.693.00	8.965.133.00	153
12	Mjete transportuese	014		28.668.886.00	33.035.388.00	87
13	Vegla, inventari i kancelarive dhe instalimeve, mobile	015				
14	Mjete biologjike	016				
15	Avance për furnizim të mjeteve materiale	017				
16	Mjete materiale në përgatitje	018				
17	Mjete tjera materiale	019				
18	III. INVESTIME NË PATUNDSHMËRI	020				
19	IV. MJETE AFATGJATE FINANCIARE	021	7.3		55.186.000.00	

	(022+023+012+025+026+030)					
20	Investime në filiale	022				
21	Investime në shoqëri përcjellëse dhe pjesëmarrje në investime të përbashkëta	023			55.186.000.00	
22	Kërkesa sipas huazimeve të dhëna afatgjate për shoqëritë e konektuar	024				
23	Kërkesa sipas huazimeve të dhëna afatgjate	025				
24	Investime në letrat afatgjate me vlerë (027+028+029)	026				
24.a	Investime në letrat me vlerë që ruhen deri në arritje	027				
24.b	Investime në letrat me vlerë, të disponueshme për shitje	028				
24.c	Investime në HV sipas vlerës objektive përmes fitimit ose humbjes	029				
25	Mjete tjera afatgjate financiare	030				
26	V. KËRKESA AFATGJATE (032_034)	031				
27	Kërkesa nga shoqëritë e konektuar	032				
28	Kërkesa nga blerësit	033				
29	Kërkesa tjera afatgjate	034				
30	VI. MJETE TË PROPLONGUARA TATIMORE	035				
31	B. MJETE RRJEDHËSE (037+045+052+059)	036		143.675.999.00	125.372.607.00	115
32	I. REZERVA	037	7.4	4.629.898.00	1.514.135.00	306
33	Rezerva të lëndëve të para dhe materialeve	038		1.902.038.00	220.302.00	864
34	Rezerva të pjesëve rezerve, inventarit të imët, ambalazhit dhe auto gomave	039		2.728.860.00	1.293.833.00	211
35	Rezerva të prodhimeve të papërfunduara dhe gjysmë prodhimeve	040				
36	Rezerva të prodhimeve të gatshme	041				
37	Rezerva të mallrave tregtare	042				
38	Rezerva të mjeteve biologjike	043				

39	II. MJETE (OSE GRUPE PËR TJETËRSIM) TË PËRCAKTUARA PËR SHITJEN DHE FUNKSIONIMIN E PANDËRPRERË	044				
40	III. KËRKESA AFATSHKURTRA (046+047+048+049+050+051)	045		61.480.871.00	87.661.391.00	71
41	Kërkesa nga shoqëritë e konektuar	046	7.5	60.450.075.00	81.191.463.00	75
42	Kërkesa nga blerësit	047	7.6	990.278.00	6.401.064.00	16
43	Kërkesa për avance të dhëna nga furnizuesit	048	7.6		4.194.00	
44	kërkesa nga shteti në bazë të tatimeve, kontributeve, doganës, akcizave dhe parapagesave tjera	049	7.7		23.486.00	
45	Kërkesa nga punëtorët	050	7.8	40.,518.00	41.184.00	99
46	Kërkesa tjera afatshkurtra	051				
47	III. MJETE AFATSHKURTRA FINANCIARE (053+056+057+058)	052		32.013.709.00	23.056.746.00	139
48	Investime në letrat me vlerë (054+055)	053				
48.a	Investime që ruhen deri në arritje	054				
48.b	Investime sipas vlerës objektive përmes fitimit ose humbjes	055				
49	Kërkesa sipas huazimeve të dhëna për shoqëritë e konektuar	056	7.9	32.013.709.00	23.056.746.00	139
50	Kërkesa sipas huazimeve të dhëna	057				
51	Mjete tjera financiare afatshkurtra	058				
52	V. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTE MONETARE (060+061)	059	7.10	45.551.521.00	13.140.335.00	347
52.a	Mjete monetare	060		45.551.521.00	13.140.335.00	347
52.b	Ekvivalente monetare	061				
53	VI. SHPEN E PAGUARA PËR LLOGARITJET E PERIUDHAVE TË ARDHME (AVR)	062		169.311.00	246.948.00	69
54	AKTIVI I PËRGJITH: MJETE (001+035+036+044+062)	063		870.571.012.00	907.944.622.00	96
55	EVIDENCA JASHTË BILANCIORË AKTIVI	064		1.357.419.00	211.920.00	641

56	PASIVI A. KRYEGJËJA DHE REZERVAT (066_071+075_077-078)	065		796.144.432.00	841.368.133.00	95
57	I. KRYEGJËJA THEMELORE	066	7.11	766.019.854.00	766.019.854.00	100
58	II. PREMI TË AKSIONEVE TË EMETUARA	067				
59	III. AKSIONE PRONËSORE (-)	068				
60	IV. KAPITALI I REGJISTRUAR DHE I PA PAGUAR (-)	069				
61	V. RIVALOR I REZERV DHE DALLIME NGA VLERËSIMI I KOMPONENTËS NGA FITIMI I PËRGJITHSHËM	070		1.161.451.00	1.161.451.00	100
62	VI. REZERVA (072+073+074)	071	7.12	44.342.938.00	44.342.938.00	100
63	Rezerva ligjore	072		41.091.463.00	41.091.463.00	100
64	Rezerva statutare	073				
65	Rezerva të tjera	074		3.251.475.00	3.251.475.00	100
66	VII. FITIMI I AKUMULUAR	075	7.13		43.439.678.00	
67	VIII. HUMBJA E BARTUR (-)	076		9.973.168.00		
68	IX. FITIMI PËR VITIN AFARIST	077	7.16			
69	X. HUMBJA PËR VITIN AFARIST	078	7.16	5.026.716.00	13.595.788.00	37
70	XI. KRYEGJËJA E PRONËSISË SË SHOQËRISË AMË	079				
71	XII. PJESEMARRJE E PAKONTROLLUAR	080				
72	B. OBLIGIME (082+085+095)	081	7.17	50.168.281.00	39.225.716.00	128
73	I. REZERV AFATGJATE PËR RREZIQE DHE SHPENZIME (083+084)	082				
74	Rezerva për pensione, dërgesa dhe obligime ndaj furnizime	083				
75	Rezerva tjera afatgjate për rreziqe dhe tjera	084				
76	II. OBLIGIME AFATGJATE (086_093)	085				
77	Obligime ndaj shoqërive të konektuar	086				
78	Obligime ndaj furnizuesve	087				

79	Obligime për avance, depozita dhe kaucione	088				
80	Obligime sipas huazimeve dhe kredive me shoq e konektuar	089				
81	Obligime sipas huazimeve dhe kredive	090				
82	Obligime sipas letrave me vlerë	091				
83	Obligime tjera financiare	092				
84	Obligime tjera afatgjate	093				
85	III. OBLIGIME TË PROLONGUARA TATIMORE	094				
86	IV. OBLIGIME AFATSHKURTRA (096_108)	095	7.16	50.168.281.00	39.225.716.00	128
87	Obligime ndaj shoqërive të konektuar	096		3.679.288.00	1.521.396.00	242
88	Obligimi ndaj furnizime	097		23.281.941.00	20.208.692.00	116
89	Obligime për avance, depozita dhe kaucione	098			37.507.00	
90	Obligime për tatime dhe kontribute të pagës dhe kompensime të pagës	099		6.793.110.00	5.221.540.00	130
4.634	Obligime ndaj punonjësve	100		14.685.110	11.131.058.00	132
9.992	Obligime rrjedhëse tatimore	101		1.528.524.00	1.068.959.00	143
8.376	Rezerva afatshkurtra dhe rreziqe dhe shpenzime	102				
94	Obligime për huazime dhe kredi me shoq e konektuar	103				
95	Obligime për huazime dhe kredi	104				
96	Obligime për letrat me vlerë	105				
97	Obligime në bazë të pjesëmarrjes në rezultate	106				
98	Obligime tjera financiare	107				
99	Obligime tjera afatshkurtra	108		200.308.00	36.564.00	548
100	V. PAGESA E PROLONGUAR E SHPENZIMEVE DHE TË ARDHURA PËR PERIUDHAT E ARDHME (PVR)	109	7.18	23.878.372.00	27.350.773.00	88
101	VI. OBLIGIME SIPAS MJETEVE THEMELORE JO RRJEDHËSE (OSE GR.	110				

	PËR TJETËRSIM) QË RUHEN PËR SHITJE DHE PUNË TË NDËRPRERA					
102	GJITHSERJ PASIVI: KRYEGJËJA, REZERVA DHE OBLIGIME (065+081+094+109+110)	111	7.19	870.571.012.00	907.944.622.00	96
103	EVIDENC JASHTË BILANCORE - PASIVI	112		1.357.419.00	211.920.00	641

SHËNIMET PËRCJELLËSE TË RAPORTEVE FINANCIARE

1. Qëllimet e raporteve financiare

Qëllimi i raporteve financiare është ofrimi i informacioneve për gjendjet financiare, rezultati dhe ndryshimet në gjendjen financiare, që nevojiten për një numër të madh të shfrytëzuesve të këtyre raporteve.

Njëra prej karakteristikave më të rëndësishme të raporteve financiare është ajo se të njëjtat përgatiten në bazë të llogaritjeve të kontabilitetit, gjatë kësaj parimi i zbatuar i pranon efektet nga transaksionet kur do të shfaqen. Transaksionet e shkaktuara, pa prolongim duhet të evidentohen në evidencën e kontabilitetit që është bazë për përpilimin e raporteve financiare. Në këtë mënyrë, jepen informacione për shfrytëzuesit e raporteve jo vetëm për ngjarjet e kaluara që përfshijnë pagesën ose pranimin e mjeteve monetare, por edhe për obligimet për të cilat duhet të paguhen mjete monetare në periudhën e ardhshme.

Karakteristikat themelore kualitative të raporteve financiare janë:

- Kuptueshmëria;
- Relevanca;
- Materialiteti;
- Besueshmëria;
- Esenca mbi formën;
- Neutraliteti;
- Kujdesi;
- Krahasueshmëria.

2. BAZA PËR PËRGATITJEN E RAPORTEVE FINANCIARE

Raportet financiare të Ndërmarrjes publike “Parqe dhe gjelbërime” janë të përpiluara në pajtim me Ligjin për ndërmarrjet publike (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 38/96.....64/18), Ligjit për shoqëritë tregtare (Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 28/04..... dhe nr. 120/18) dhe Rregullores për drejtim të kontabilitetit (“Gazeta zyrtare e RM-së”

nr. 159/09, 164/10 dhe 107/11), përkatësisht sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit – SNK, Standardeve ndërkombëtare për njoftim financiarë - SNNJF, Interpretimet e Komitetit permanent për interpretime - KPI dhe Interpretimet e Komitetit për interpretim të njoftimit ndërkombëtarë financiarë - KINJNF të përcaktuar nga Këshilli për standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

Raportet financiare janë të përpiluara me zbatimin e metodës së vlerës furnizuese dhe në bazë të parimit të vazhdimit të funksionimit.

Këto raporte financiare përfshijnë kërkesat, obligimet, rezultatet operative, ndryshimet në kryegjënë dhe rrjedhat monetare të Ndërmarrjes.

Raportet financiare të Ndërmarrjes janë të shprehura në mijë denarë.

Denari paraqet valutën zyrtare njoftuese të Ndërmarrjes.

3. PASQYRË E POLITIKAVE MË TË RËNDSISHME TË KONTABILITETIT

3.1. PATUNDSHMËRITË, INSTALIMET DHE PAJISJET

Patundshmëritë dhe pajisjet janë të prezantuara sipas çmimeve furnizuese, të zvogëluara për amortizimin e llogaritur.

Vlera furnizuese përbëhet prej vlerës së faturuar të zmadhuar për shpenzimet importuese dhe tatimeve të pakthyeshme, si dhe shpenzimet që në mënyrë të drejtpërdrejtë mund ti përshkruhen sjelljes së mjetit në gjendje funksionale (shpenzimet për: përgatitjen e vendit (rrafshimi, ndërtimi i mureve mbështetëse, kanaleve për ujitje, shpenzimet për rrënimet të ndërtimeve të vjetra), dorëzimi dhe manipulimi, instalimi dhe montimi si dhe shërbimet për profesionistët dhe të ngjashme). Të gjitha lirimet tregtare dhe rabatet do të hiqen që të fitohet çmimi i blerjes. Vlera furnizuese e mjetit që prodhohet në regji pronësore, përcaktohet me shfrytëzimin e parimeve të njëjta sikur edhe për mjetin e fituar.

Shpenzimet për mirëmbajtjen dhe riparimin e mjeteve, të a.q. shpenzime për mirëmbajtje investuese, pranohen si shpenzime të periudhës së caktuar.

Shpenzimet investuese janë ato mjete me të cilat vazhdohet afati i përdorimit të mjeteve, zmadhohet kapaciteti i tyre, zmadhohet cilësia e prodhimeve që prodhohen me atë mjet ose zvogëlohen shpenzimet e prodhimtarisë së atyre prodhimeve.

Vlera e shpenzimeve investuese i shtohet vlerës furnizuese dhe baza e zmadhuar në mënyrë të tillë, amortizohet.

3.2. MJETET JO MATERIALE

Mjetet jo materiale, përbëhen prej pakove të softuerit.

Mjetet jo materiale prezantohen sipas vlerës furnizuese të tyre, të zvogëluar për amortizimin e akumuluar.

Shpenzimet lidhur me mirëmbajtjen e softuerit, pranohen si shpenzime në çastin e shfaqjes së tyre.

3.3. AMORTIZIMI

Amortizimi i patundshmërive, pajisjeve dhe mjeteve jo materiale, llogaritet në mënyrë proporcionale, me qëllim që vlera furnizuese e mjetit, tërësisht të shlyhet në periudhën e vlerësuar të leverdisë.

Amortizimi i patundshmërive, pajisjeve dhe i mjeteve jo materiale, realizohet sipas shkallëve që bazohen në afatin e vlerësuar të leverdisë së mjeteve nga ana e Udhëheqësisë së ndërmarrjes.

Shkallët e përcaktuara vjetore të amortizimit, që shfrytëzohen për grupe të caktuara të patundshmërive, pajisjeve dhe mjeteve jo materiale, me sa vijon:

Patundshmëritë	2.5%-10%
Inventari afarist	10%
Pajisjet	10%-25%
Mobilet	25%
Pajisjet kompjuterike dhe softueri	25%
Pajisjet e telekomunikacionit dhe automjetet	10%-25%
Mjetet jo materiale	25%

Amortizimi i mjetit, filloj kur i njëjti lëshohet në përdorim, përkatësisht kur gjendet në lokalitetin dhe në kushtet e domosdoshme, që i njëjti të jetë i aftë në aspekt operativ dhe në mënyrën e paraparë nga udhëheqësia.

3.4. REZERVAT

Lëndët e para, materialet, pjesët rezerve, inventari i imët, ambalazhi dhe gomat automobilistike, evidentohen sipas shpenzimeve furnizuese. Vlera furnizuese e rezervave përbëhet nga çmimi furnizues, dogana e importit, tatimet e

pakthyeshme, shpenzimet për transport si dhe shpenzimet tjera që janë shkaktuar në lidhje me furnizimin. Shpenzimi i vlerës furnizuese të rezervave përcaktohet sipas metodës së të parës hyrëse dhe të parës dalëse (RF OF). Inventari i imët çregjistrohet 100 % gjatë lëshimit në përdorim, por edhe më tej mbetet në evidencën jashtë bilancit, deri në çregjistrimin në bazë të propozimit të komisionit për regjistrime.

3.5. KËRKESAT AFATSHKURTRA

Kërkesat afatshkurtra, prezantohen sipas vlerës së tyre nominale. Korrigjimi për zhvlerësimin e kërkesave, prezantohet kur ekziston dëshmi objektive se Ndërmarrja nuk do të mund të paguaj të gjitha shumat e arritura në pajtim me kushtet origjinale, në bazë të cilave janë gjeneruar kërkesat.

Çregjistrimi i kërkesave realizohet në bazë të strukturës së vjetërsisë së kërkesave dhe përvojës historike, dhe kohës kur vlerësohet se pagesa e pjeshme ose e tërësishme e kërkesës më nuk është e besueshme.

Vlera e kërkesës zvogëlohet përmes korrigjimit të vlerës së kërkesave të dyshimta dhe kontestuese, përkatësisht për harmonizimin vlerësor të kërkesës sipas aspektit të afatit.

3.6. TATIMI I FITIMIT

Tatimi i fitimit përcaktohet dhe paguhet sipas Bilancit tatimor vjetor dhe i njëjti paraqet zë shpenzues nga rezultati financiarë para tatimit në Bilancin e suksesit (Raporti për fitimin gjithë përfshirës).

3.7. PARATË DHE EKVIVALENTET MONETARE

Paratë dhe ekuivalentet monetare, përbëhen prej mjeteve në llogaritë e transaksioneve, arkën dhe në investimet tjera me likuiditet të lartë me arritje inicuese deri në tre muaj.

3.8. OBLIGIMET AFATSHKURTRA

Obligimet ndaj furnizuesve dhe obligimet tjera, fillimisht pranohen sipas vlerës objektive, dhe më pas maten sipas vlerës së amortizimit duke e shfrytëzuar metodën

e shkallës efektive të normës së interesit. Këto obligime klasifikohen si afatshkurtra, nëse në datën e përpilimit të Raportit të gjendjes financiare, gjendja e afatit të arritjes është 12 muaj.

3.9. TË ARDHURAT

Të ardhurat pranohen deri në nivelin deri kur është e besueshme se ndërmarrja do të realizoj të hyra nga leverdi të ardhme ekonomike dhe se këto leverdi do të mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen sipas vlerës objektive të kompensimeve të pranuar ose të kërkesës për të mirat dhe shërbimet e shitura, të zvogëluara për diskontet e lejuara, rabatet dhe tatimin e vlerës së shtuar. Kompensimet nga shërbimet e siguruar, pranohen për periudhën në të cilën shërbimet janë të dhëna dhe të pranuar nga blerësi. Të ardhurat nga shitja e mallrave, pranohen kur rreziku i rëndësishëm nga ndarja e pronësisë së mallrave do ti bartet blerësit, zakonisht me dorëzimin e mallrave.

3.10. SHPENZIMET

Shpenzimet pranohen në lartësi të shpenzimeve të krijuara me qëllim që të realizohen të ardhurat, në periudhën kur pranohen të ardhurat përkatëse.

3.11. PËRKRAHJET SHTETËRORE

Përkrahjet shtetërore nga pushteti qendrorë dhe nga pushteti lokal, pranohen sipas vlerës së tyre objektive në bilancin e suksesit, kur ekziston besimi racional se janë përmbushur kushtet lidhur me të njëjtit dhe se përkrahjet do të pranohen. Përkrahjet, Shoqëria i njeh në fitimin ose në humbjen në bazën sistematike në periudhat në të cilat i njeh si shpenzime – shpenzimet e lidhura për të cilët vlejné dhe janë të përcaktuara përkrahjet me qëllim të kompensimit të tyre.

4. VLERËSIMET E SHFRYTËZUARA

Shoqëria realizon vlerësime dhe supozime racionale të përcaktuara në bazë të përvojave të kaluara si dhe në bazë të faktorëve tjerë, por nëse nuk ekzistojnë informacione tjera relevante.

4.1 Zhvlerësimi i patundshmërive, instalimeve dhe i pajisjeve

Shoqëria e vlerëson zhvlerësimin e patundshmërive, instalimeve dhe të pajisjeve, kur ekziston shkaku - arsyeja për zhvlerësim, përkatësisht kur vlera e kontabilitetit në masë të konsiderueshme e tejkalon vlerën kompensuese. Vlera

kompensuese përcaktohet përmes llogaritjes së vlerës shfrytëzuese, gjatë kësaj shfrytëzohet një gamë e gjerë e supozimeve dhe informacioneve të cilët ndikojnë mbi të njëjtit. Përkaj tjerave, merren parasysh edhe të ardhurat dhe shpenzimet e ardhme, skadimi teknologjik, diskontinuiteti i prodhimit dhe shërbimet dhe faktorët tjerë që mund të rezultojnë me zhvlerësimin e patundshmërive, instalimeve dhe të pajisjeve.

4.2. Korrigjimi i vlerës së kërkesave

Korrigjimi i vlerës së kërkesave, realizohet në bazë të vlerësimit të mundësisë së pagesës sipas përvojave tjera, aftësisë kreditore të blerësve dhe ndryshimet e pritura në kushtet e pagesës.

4.3 Harmonizimi vlerësorë i rezervave

Harmonizimet vlerësore (korrigjimet) të cilat evidentohen në barë të shpenzimeve tjera, realizohen në rastet kur do të vlerësohet se nevojitet vlera e kontabilitetit të rezervave, që të sajohet vlera neto e realizimit të tyre.

5. MENAXHIMI ME RREZIQE

5.1 Rreziku i tregut

Rreziku i tregut paraqet rrezikun nga ndryshimi i çmimeve të tregut, ndryshimi i kurseve në valutat e huaja dhe ndryshimi i normave të interesit që kanë ndikim mbi të ardhurat e Shoqërisë ose mbi vlerën e instrumenteve financiare. Qëllimi i menaxhimit me rrezikun e tregut është kontrollimi i ekspozimit ndaj rrezikut të tregut në suaza të pranueshme si dhe optimizimi i rikthimit të mjeteve.

5.2 Rreziku nga likuiditeti

Menaxhimi i kujdesshëm me rrezikun nga likuiditeti, implikon mirëmbajtjen e mjaftueshme të parave të gatshme dhe të letrave likuide me vlerë, më pas disponimin e burimeve të mjeteve përmes sigurimit përkatës të kredive si dhe mundësia për pagesën në kohë, në suaza të kushteve të caktuara të shumave të kërkesave të blerësve. Udhëheqësia e Shoqërisë në masë të madhe është përgjegjëse për përcjelljen ditore të gjendjeve lidhur me rrezikun nga likuiditeti.

Sipas Raportit për fitimin ose humbjen (Bilanci i suksesit), NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup gjatë vitit 2018, i ka realizuar këto rezultate financiare:

1. Realizimi i të ardhura ve të përgjithshme	455.669.275,00 denarë
- Të ardhura të realizuara nga funksionimi	455.650.916,00 denarë
- Realizimi i të ardhurave financiare	18.359,00 denarë.
Realizimi i shpenzimeve të përgjithshme	455.289.348,00 denarë
- Shpenzime të realizuara nga funksionimi	455.093,300,00 denarë
- Realizimi i shpenzimeve financiare	196.048,00 denarë
3. Fitimi i realizuar para tatimit (1-2)	379.927, 00 denarë
4. Tatimi i fitimit	5.406.643,00 denarë
5. Neto humbja pas tatimit	5.026.716,00 mijë denarë

6. Shënime përcjellëse të raportit për fitimin ose humbjen (Balanci i suksesit)

6.1. Të ardhura nga shitja

Të ardhurat nga shitja gjatë vitit 2018 janë në shumën prej 406.201.614.00 denarë (gjatë vitit 2017 – 385.037.652.00 denarë) dhe të njëjtit janë realizuar në bazë të:

Përshkrimi	2018	2017	Indeksi
Të ardhura nga shoqëritë e konektuar (NP "Ujësjiellësi dhe kanalizimi" - Shkup)	261.603.505,00	270.136.024,00	97
Të ardhura nga shitja, Qyteti i Shkupit	141.209.170,00	111.149.674,00	127
Të ardhura nga sjellja e sipërfaqeve të gjelbëruara në gjendje fillestare dhe nga pastrimi i sipërfaqeve publike të gjelbëruara pas evenimenteve të organizuara dhe nga prerja e drunjve	847.657,00	1.413.262,00	60
Të ardhura nga qiraja	2.327.150,00	2.338.692,00	100
Të ardhura tjera	214.132,00		
Gjithsej:	406.201.614,00	385.037.652,00	105

Të ardhurat nga shoqëritë e konektuara kanë të bëjnë me të ardhurat nga NP "Ujësjiellësi dhe kanalizimi" të cilat fitohen si kompensim për mirëmbajtje të gjelbërimit urban dhe jashtë urban në pajtim me Programin vjetorë të miratuar nga Këshilli i Qytetit të Shkupit, përkatësisht 19,5 % të llogarive të përgjithshme të faturuara nga uji dhe ujërat e zeza prej shfrytëzuesve final.

Të ardhura nga Qyteti i Shkupit, në pjesën më të madhe janë realizuar nga shërbimet e realizuara për rregullim horti kulturorë i sipërfaqeve të reja publike, më pas nga mbjellja e luleve sezonale dhe e fidanëve në sipërfaqet publike në territorin e Qytetit të Shkupit, si dhe në pajtim me Kontratat për rregullim të park pyllit Vodno dhe Gazi Baba për vendosjen e flamujve.

Të ardhurat nga qiraja kanë të bëjnë me të ardhurat nga rimorkiot e lokalizuara në L. Treska dhe nga tezgat e dhëna me qira nëm Tregun e luleve.

Të ardhurat nga shitja janë të zmadhuar për 5 % krahas vitit 2017 si rezultat i të ardhurave të zmadhuara nga Qyteti i Shkupit .

Mjetet e paguara nga NP "Ujësjiellësi dhe kanalizimi" janë prezantuar në tabelën vijuese:

Përshkrimi	2018	2017	Indeksi
Mjete të paguara nga NP "Ujësjetësi dhe kanalizimi"	269.235.012,00	206.028.982,00	131
Gjithsej:			

Shuma e paguar gjatë vitit 2018 është më e ulët për 31 % krahas vitit 2017.

6.2. Të ardhura tjera afariste

Të ardhurat tjera gjatë vitit 2018, në shumë prej 49.449.302,00 denarë (2017 – 32.693.985,00 denarë) janë të realizuara në bazë të:

Përshkrimi	2018	2017	Indeksi
Të ardhurat nga kërkesat e paguara të çregjistruara	28.632.055,00	27.614.909,00	104
Të ardhura nga çregjistrimi i obligimeve		313.759,00	
Të ardhura nga subvencioneve, dotacionet	20.586.271,00	4.650.226,00	443
Të ardhura nga kompensimi i dëmeve nga kompanitë e sigurimeve	182.835,00	15.368,00	1190
Të ardhura nga vitet e kaluara		16.357,00	
Të ardhura tjera të pa përmendura afariste	48.141,00	83.366,00	58
Gjithsej:	49.449.302,00	32.693.985,00	151

Të ardhurat nga kërkesat e paguara dhe të çregjistruara, kanë të bëjnë me të ardhurat e realizuara nga kërkesat e çregjistruara por të paguara dhe nga pagesa e kërkesave të dyshimta dhe kontestuese nga ana e NP "Ujësjetësi dhe kanalizimi" prej shfrytëzuesve final dhe një pjesë e vogël për kërkesat e paguara të çregjistruara nga L. Treska.

Të ardhurat nga çregjistrimi i obligimeve kanë të bëjnë me të ardhurat nga obligimet e çregjistruara në bazë të Vendimit të regjistrimit nga Këshilli Drejtues.

Të ardhurat nga subvencionet, dotacionet, kanë të bëjnë me të ardhurat në bazë të subvencioneve të pranuar nga Qyteti i Shkupit, në pajtim me Vendimin e miratuar nga Këshilli i Qytetit të Shkupit edhe atë për vitin 2018 - 15.000.000,00 denarë për tejkallim të vështirësive gjatë funksionimit dhe 3.000.000,00 denarë për organizim të Festivalit të luleve dhe 2.574.070,00 denarë për amortizimin e llogaritur për mjetet e fituara nga Qyteti i Shkupit (Automjeti ngarkues kamion dhe traktori). Për vitin 2017, 3.000.000,00 denarë për organizim të Festivalit të luleve dhe 1.650.000,00 denarë për amortizimin e llogaritur për mjetet e fituara nga Qyteti i Shkupit (Automjeti ngarkues kamion dhe traktori).

Të ardhurat nga kompensimi i dëmeve nga kompanitë e sigurimeve kanë të bëjnë me të ardhurat e fituara nga kompania e sigurimeve në bazë të vjedhjes së realizuar të pajisjeve në ndërmarrjen.

Të ardhurat nga vitet e kaluara, kanë të bëjnë me të ardhurat e paguara nga vitet e kaluara.

Të ardhurat tjera të pa përmendura afariste i përfshijnë të ardhurat nga dënimet e punëtorëve nga pagat, dhe të ardhura të tjera të pa përmendura afariste.

6.3. Shpenzimet për lëndë të para dhe materiale tjera

Shpenzimet materiale i përbëjnë shpenzimet e krijuara gjatë funksionimit operativ, edhe atë:

Përshkrimi	2018	2017	Indeksi
Lëndë të para dhe materiale të shpenzuara	71.814.910,00	62.675.527,00	115
Materiale të shpenzuara të zyrave	370.854,00	249.155,00	149
Energjia dhe lëndët djegëse të shpenzuara	10.083.188,00	8.493.775,00	119
Pjesë të shpenzuara rezerve	5.211.676,00	4.671.971,00	112
Çregjistrimi i inventarit të imët dhe i auto gomave	1.577.133,00	1.086.402,00	145
Çregjistrimi i pajisjeve HTZ	945.865,00		
Gjithsej:	90.003.626,00	77.176.830,00	117

Mjetet e shpenzuara materiale për 17 % janë më të larta krahas vitit 2017, si rezultat i shpenzimeve të zmadhuara për lëndët e para dhe materialet si rezultat i aktiviteteve të zmadhuara të ndërmarrjes rreth ngritjes së sipërfaqeve të reja të gjelbëruara dhe nga mbjellja e luleve sezonale dhe tëfidanëve në territorin e Qytetit të Shkupit. Në mënyrë proporcionale me të ardhurat e zmadhuara nga Qyteti i Shkupit, zmadhohen edhe shpenzimet për lëndët e para dhe materialet e shpenzuara.

Lëndë të para dhe materiale të shpenzuara përfshijnë materialet e shpenzuara, materiale të tjera të shpenzuara, lëndë të para të shpenzuara, fara të shpenzuara, rasatit, rrjetit të hidrantit, fidanëve, materiale ndihmëse shpenzuese.

Energjia e shpenzuar ka të bëjë për energji elektrike, lënda djegëse e shpenzuar, naftë dhe vajra të shpenzuara motorike.

Pjesë të shpenzuara rezerve kanë të bëjnë me furnizimet e pjesëve rezerve për mirëmbajtje të automjeteve zyrtare dhe mekanizimit tjetër të imët, siç janë kositëse e barit, trimerë etj.

Çregjistrimi i inventarit të imët përfshin shpenzimet për furnizim të inventarit të imët dhe auto gomave për nevojat e ndërmarrjes.

6.4. Shërbime të karakterit të shpenzimeve materiale

Përshkrimi	2018	2017	Indeksi
Shërbime transportuese	54.864,00	149.430,00	37
Shpenzime për shërbime postare dhe të telefonisë	1.310.350,00	1.248.562,00	105
Huazimi i pajisjeve	146.254,00	49.375,00	296
Shpenzime për shërbime komunale, ujë dhe taksa për mbeturina	2.031.766,00	1.997.911,00	102
Shpenzime për hulumtime		2.342.300,00	
Shërbime tjera	46.998.307,00	44.451.936,00	106
Gjithsej:	50.541.541,00	50.239.514,00	100

Shërbimet për PTT dhe për shërbimet e telefonisë kanë të bëjnë me shpenzimet postare, shërbimet për transport të personave, shpenzimet telefonike, shpenzimet për celularë.

Shërbimet për mirëmbajtje dhe mbrojtje kanë të bëjnë me shërbimet për mirëmbajtje të rregullt.

Shpenzimet për hulumtime gjatë vitit 2017 kanë të bëjnë me planin e posaçëm të përpiluar për kultivimin dhe mbrojtjen e park – pyllit Vodno për periudhën 2017 – 2027 nga ana e Fakultetit të Pylltarisë.

6.4.1. Shpenzime për shërbime tjera

Shpenzimet për shërbimet tjera përfshijnë:

Përshkrimi	2018	2017	Indeksi
Shpenzime për reklama dhe propagandë	36.067,00	36.462,00	99
Shërbime për regjistrime të automjeteve	235.670,00	186.048,00	127
Shërbime për botime, fotokopjime dhe kopertinime	51.038,00	5.351,00	954
Agjencia për punësime të përkohshme	36.804.613,00	40.829.105,00	90
Shërbime për ngarkim dhe transport të mbet ndërimore	7.623.141,00	960.193,00	794
Shërbime zeytare	2.204.489,00	2.233.616,00	99
Shpenzime për mirëmbajtjen e softuerit	43.289,00	201.161,00	22
Gjithsej:	46.998.307,00	44.451.936,00	106

Shërbime të tjera kanë të bëjnë me shërbimet prodhuese, shpenzime për regjistrim dhe kontrollim teknik të automjeteve zyrtare ngarkuese dhe të udhëtimit, shpenzime për punëtorë sezonal të angazhuar përmes Agjencisë për punësime të përkohshme dhe shpenzime të tjera.

6.5. Shpenzime të tjera nga funksionimi

Shpenzimet tjera nga funksionimi përbëhen prej:

Përshkrimi	2018	2017	Indeksi
Shpenzime për anëtarët e organit të menaxhimit	1.514.000.00	1.475.904.00	103
Shpenzime për sponsorime dhe donacione	309.500.00	33.000.00	938
Shpenzime për prezantime	688.505.00	1.466.988.00	47
Premi për sigurime	470.147.00	288.896.00	163
Shpenzime për shërbime bankare	220.141.00	216.433.00	102
Tatime, kontribute dhe të dhëna tjera që nuk varen nga rezultati	290.988.00	320.566.00	91
Shpenzime tjera jo materiale	2.885.837.00	2.673.964.00	108
Gjithsej:	6.379.118.00	6.475.751.00	99

Shpenzimet për anëtarët e organit të menaxhimit kanë të bëjnë me kompensimet e anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe Mbikëqyrës.

